LIGJ
Nr.10 141, datë 15.5.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9739, DATË 21.5.2007 "PËR SHËRBIMIN E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9739, datë 21.5.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni l

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Gjaku, produkt i mbledhur dhe i shpërndarë pa fitim

1. Gjaku njerëzor nuk mund të përdoret në shërbimin shëndetësor për qëllime fitimi. Shpenzimet për procedurat e kontrollit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së gjakut e të përbërësve të tij, në asnjë rast, nuk përballohen nga pacienti. Këto shpenzime i mbulohen Shërbimit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut nga institucionet shëndetësore që e përfitojnë këtë shërbim.

2. Kostoja për secilin nga shërbimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.".

Neni 2

Në nenin 12 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas shkronjës "b"shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) mënyrën e lëvrimit të fondeve për veprimtaritë promovuese dhe edukative në fushën e transfuzionit të gjakut.".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Ministri i Shëndetësisë përcakton kërkesat e bazës organizative e teknike të strukturave, si dhe të veprimtarive promovuese e edukative të shërbimit të transfuzionit.".

Neni 3

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 13/1
Financimi i organizatave jofitimprurëse që promovojnë dhurimin vullnetar të gjakut

1. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut financon, me fondet buxhetore, të dhëna për këtë qëllim, shpenzimet e promocionit të çdo organizate jofitimprurëse, që

promovon dhurimin vullnetar të gjakut.

2. Kostoja e promocionit për çdo dhurim dhe mënyra e financimit të promocionit të organizatave jofitimprurëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6199, datë 5.6.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi